



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Drejtësisë

N J O F T I M

PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR EKSPERT NË SESIONIN PRILLIT 2023

Paraqitja e provimit është nga 1 deri më 15 mars 2023

-Njoftohen të gjithë kandidatët që janë të interesuar të japin provimin profesional për ekspert të parashtrojnë Kërkesë për dhënie e provimit në (1) një nga fushat e cekura më poshtë:

- Punë materiale, kontabiliteti dhe financiare
- Komunikacion
- Bujqësi
- Pylltari
- Psikiatri

Kandidati që paraqitet për të dhënë provimin profesional për ekspert duhet të dërgojë këto dokumente:

- Kërkesë me fletëpagesë për taksë administrative prej **50 denar**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë (Certifikatë Shtetësie jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje e verifikuar në noter)
- Të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë (kopje e letërnjoftimit valid)

- Kopje të Diplomës të verifikuar në noter për arsimim të lartë të përfunduar nga fusha përkatëse (diplomë e arsimimit të lartë (4) katër vjeçar ose diplomë me 300 kredi sipas ECTS-së)

- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk ju është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës (Original/Kopje e verifikuar në noter) jo më të vjetër se 6 muaj.

- Vërtetim për së paku (5) vjet përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën është bërë kërkesë për dhënien e provimit profesional (origjinal ose kopje e verifikuar në noter)

Përveç dokumenteve të lartë cekura, duhet të bëhet pagesa në fletëpagesë PP/50, me këto të dhëna:

- Qëllimi i pagesës – **për dhënien e provimit profesional për ekspert**

- Emri i pranuesit : **Ministria e Drejtësisë**

- Banka e pranuesit: **Banka Popullore e RM-së**

- Fletëpagesa e llogarisë transaksione: **100000000063095**

- Shuma: **9,000,00 denar**

- Llogaria e shfrytëzuesit buxhetor: **070010014063112**

- Shifra e të ardhurave dhe programi: **723013-10**

PAGESA E TAKSËS ADMINISTRATIVE

Paguhet në xhirollogarinë në formularin PP 50

Nga ana e djathtë:

- Emri dhe selia e pranuesit – Buxheti i RM-së
- Banka e pranuesit – BPRM

- Llogaria transaksione: 10000000063095
- Llogaria paguese: 840 Shifra e komunës 03161
- Shifra e të ardhurave dhe programi: 723013 00

Personi përgjegjës për të vërtetuar plotësimin e kushteve për dhënien e provimit profesional për ekspertë:

Arsim Nuredini